



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



DATA/DATUM	07-08-2020
PER/ZA	Z. ASTRIT BLLACA- DREJTOR I DEPARTAMENTIT TE AUDITIMIT
PERMES/PREKO	Z. VLADICA ARITONOVIC-KRZETAR I KOMUNES
NGA/OD	XHAVIT KRASNIQI- Drejtor i drejtoratit per buxhet, financa, inspektion dhe zhvillim ekonomik
LENDI/PREDMET	Plani i veprimit per zbatimin e rekomandimeve per vitin 2019

Të nderuar, po Ju dergojmë Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve për Komunen e Ranillugut për vitin 2019.


Me respekt,

Xhavit Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 07.08.2020		10.08.2020	
Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot Prot. No	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
04	47	1395	18



Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Vladica Artonović, Kryetar i komunës së Ranillugut

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE**

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komentet
1.	<p>2.1.1 Të hyrat</p> <p>Çështja A1 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave</p>	<p>Sipas nenit 15.2 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme parashihet që veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të gjitha objekteve brenda territorit të komunës.</p> <p>Komuna në vitin 2019, prej 1,353 pronave të regjistruara kishte arritur të kryej verifikimin e vetëm 12 objekteve apo më pakë se 1% të pronave të paluajtshme.</p> <p>Sipas zyrtareve komunal kjo ka</p>	<p>Rekomandimi A1</p> <p>Kryetari duhet të marrë në konsideratë plotësimin e vendeve të punës në këtë departament, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer verifikimin e objekteve sipas dispozitave ligjore.</p>	<p>Me qëllim të regjistrimit të objekteve të reja dhe rianketimit të mes paku 20% të objekteve ekzistuese , kemi angazhuar edhe nje zyrtar me kontrate ne veper ne sektorin e Tatimit ne prone.</p>	<p>Xhavit Kraniqi, Drejtor i DBFIZI HE, dhe Miroslav Kostic, udhedheheqes i Zyres se Tatimit ne prone.</p>	<p>31-12-2020</p>	

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel + 383 (0) 280 315 001, Fax + 383 (0) 49 779 064, + 383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aritonic@rks.gov.net
 Adresa: Adresesa e Komunës së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

		ndodhur për shkak se në njësinë e tatimit në pronë është i punësuar vetëm një zyrtar, i cili për shkak të vëllimit të punëve, nuk kishte mundësi të përmbush ketë kërkesë lipjore.					
2.	2.1.2 Pagat dhe mëditjet Çështja A2 - Mangësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit	Sipas Udhëzimit Administrativ 07/2017, mbi rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nenet 7,9,11,12 mes tjerash përcaktojnë se tetë ditë pas shpalljes së konkursit, përpilohet lista me kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e vendosura në konkurs. Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret ftohën në test me shkrim, shpallën rezultatet me pikët e fituara nga testi, dhe ata të cilët kalojnë testin ftohën në intervistë. Më pastaj	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se gjatë punësimit të punonjësve të rinj, të zbatohen të gjitha kërkesat e Udhëzimit Administrativ në fuqi.	Me rastin e shpalljes se konkursit për pranim(rekrutim) të punetoreve të rinje do të kerkoje që të respektohet Udhëzimi administrativ nr. 07/2017, mbi rregullimin e procedurave të konkursit neni 7,9,11 dhe 12.	Ivan Mitkovic, drejtor i drejtoratit për Arsim, shendetesi, Qesjtje sociale, Rini, Kulture dhe Sport. Milos Tomoc, drejtor i drejtoratit për Administrate dhe personel	30-09-2020	

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel +383 (0) 280 315 001 / Mob -383 (0) 49 779 064 / +383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aritovic@rks.gov.net
Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ramillgut, P.n. 62000, Komuna e Ramillgut, Republika e Kosovës

		<p>komisioni shpallë listën përfundimtare e të gjithë pjesëmarrësve në intervistë në të cilën është këshilla juridike për kandidatët e pakënaqur, ku ata kanë të drejtë ankese, në komisionin e ankesave i cilit formohet tri ditë pas shpalljes së konkursit.</p> <p>Tri mostra të audituara në drejtorinë e Arsimit, dosja e konkursit nuk përmbante listën e kandidatëve që kanë aplikuar; Komisioni i përzgjedhës nuk kishte përpiluar listën e kandidatëve të cilët kanë plotësuar kriteret e konkursit; Munjonin formularët e vlerësimit për pikët me shkrim dhe në intervistë; Në vendimin mbi</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel +383 (0) 280 315 001 - Mob +383 (0) 49 779 064 - 383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.antonovic@arkys.gov.net
 Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ramillugut, P.n. 62000, Komuna e Ramillugut, Republika e Kosovës

		përzgjedhjen përfundimtare, nuk është cekur numri i poenëve të fituar, si dhe as këshilla juridike në bazë të cilës kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese, pasi që komisioni i ankesave as nuk ishte formuar. Ne nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga zyrtarët përkatës për mos zbatim të kërkesave të rregullores.					
3.	2.1.3 Mallrat dhe shërbimet Çështja A3 – Mos emërimi i menaxherëve të kontratave	Pika 61.4 e RRUOPP përcakton se pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ “/KA” dhe ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të kontratës/projektit përgjegjës për	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se për çdo kontratë të nënshkruar të emërojë edhe menaxherin e kontratës.	Me rastin e nënshkrimit të çdo kontrate me Operatoret ekonomik, do të kerkojë nga Udheheqesi i Zyres së prokurimit do të beje kerkese Zyrtarit kryesor administrativ për caktimin e menaxherit të kontratës.	Gradimir Djordjevic, udheheqes i Zyres së prokurimit dhe Milos Tomic, drejtor i drejtoratit për administratë dhe personel.	31912-2020	

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel : 383 (0) 280 315 001 Mob : 383 (0) 49 779 064, • 383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.antonovic@rks.gov.net
Adresa: Ndërrresa e Komunes së Ramillgut, P.n. 62000, Komuna e Ramillgut, Republika e Kosovës

		<p>menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratës specifike dhe për ta informuar Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit.</p> <p>Për kontratën "Furnizim me material për Zyrë" me vlerë 3,154€ dhe "Sigurimi i Automjeteve" me vlerë 4,579€ nuk është caktuar Menaxheri i Kontratës. Sipas zyrtarëve të prokurimit, menaxheret e këtyre kontratave nuk janë caktuar sepse nuk kanë qenë të informuar se duhet të caktojnë menaxher për secilën kontratë të nënshkruar.</p>				
4.	<p>2.1.4 Subvencionet dhe transferet</p> <p>Çështja A4 - Mungesa e</p>	<p>Rregullorja e MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Neni 6.1 përcakton se</p>	<p>Rekomandimi A4</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet plani vjetor për mbështetje</p>			

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel - 383 (0) 280 315 001, Mob - 383 (0) 49 779 064 - 383 (0) 44 824 282 e-mail vladica.arifonovic@rks.gov.net
 Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ranillugut, P.n 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

	planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ	<p>“Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës”.</p> <p>Ne kemi gjetur se Komuna nuk kishte përgatitur planin vjetor të subvencioneve, i cili kërkohet sipas kësaj rregullore. Arsyetimi nga zyrtarët e Komunës ka qenë që ne nuk e përgatisim një plan të tillë.</p>	financiare të OJQ-ve, në bazë të fushave dhe qëllimeve të caktuara.				
5.	2.1.5 Investimet kapitale	Sipas nenit 28.10 të Ligjit të Prokurimit Publik LPP -së,	Rekomandimi C1	Te gjitha kontraktimet per punë (ndertim te objekteve dhe	Gradimir Djordjevic, udheheqes i	31-12-2020	

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel +383 (0) 280 315 001, Mob 383 (0) 49 779 064, +383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.arifonovic@rks-gov.net
 Adresa: Ndërresa e Komunës së Ranillugut, P.n 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

	<p>Çështja C1 - Mungesa e projektit ekzekutiv të ndërtimit</p>	<p>definohet qartë se autoriteti kontraktues duhet të posedojë një projekt ekzekutiv të ndërtimit para fillimit të proceduarve të kontraktimit të punëve.</p> <p>Gjatë auditimit të kontratës "Asfaltimi i rrugëve në komunë" me vlerë 119,198€, nuk kishte projekt ekzekutiv të ndërtimit. Sipas zyrtarëve kjo ka ndodhur sepse nuk kanë ditur se duhet të ketë projekt ekzekutiv edhe për rrugët ekzistuese.</p>	<p>Kryetari të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në të kundërtën procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.</p>	<p>rrugeve), para-prakisht do të sigurohet Projekti për ekzekutimin e punëve (Projekti detaj), nga se këtu vit Komuna e ka kontraktuar Operatorin ekonomik për Hartimin e projekteve.</p>	<p>Zyres së prokurimit dhe Milos Tomic, drejtor i drejtoratit për administratë dhe personel.</p>		
6.	<p>Çështja A5 - Mos paraqitja e pagesave nga palët e jashtme në Pasqyra Financiare</p>	<p>Sipas rregullores m/nr 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 9.6 përcakton se të gjitha pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në</p>	<p>Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se paraqitja e pagesave nga palët e jashtme të bëhet sipas kërkesave të rregullores për raportim financiar.</p>	<p>Te gjitha pagesat nga Palet e treta do të paraqiten (pasqyrohen) në Pasqyrat financiare.</p>	<p>Xhavit Krasniqi, drejtor i drejtoratit për buxhet, financë, inspektion dhe zhvillim ekonomik.</p>	31-12-2020	

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel: +383 (0) 280 315 001; Mob: +383 (0) 49 779 064; +383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aritonovica.rks.gov.net
Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

		<p>SIMFK në harmoni me procedurën përkatëse dhe të prezantohen në pasqyrat financiare.</p> <p>Komuna nuk kishte regjistruar dhe paraqitur në Pasqyrat Financiare vlerën prej 6,000€, të pranuar si pagesë nga palët e jashtme e cila ishte bashkëfinancim me komunën për furnizim me pajisje sportive për sallën e sportit. Kjo ka ndodhur pasi ishte bërë një lëshim nga ana e zyrtarëve komunal.</p>					
7.	<p>2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale</p> <p>Çështja A6 – Dobësi në menaxhimin e pasurisë</p>	<p>Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 19, ndër të tjera thotë përgjegjësitë e komisionit për inventarizim janë inventarizimi i</p>	<p>Rekomandimi A6</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se inventarizimi i pasurisë të kryhet sipas rregulloreve në fuqi, ku pjesë e raportit përfundimtar të jetë edhe lista e</p>	<p>Me rastin e inventarizimit për vitin 2020, komisioni për inventarizim do të obligohet që me rastin e përfundimit të inventarizimit në fund të periudhës edhe Specifikacionin për mjetet e inventarizuara.</p>	<p>Milos Tomic, drejtor i drejtoratit për administratë dhe personel dhe Xhavit Krasniqi, drejtor i drejtoratit për buxhet, financa, inspeksi</p>	31-12-2020	

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. +383 (0) 280 315 001 - Mob. +383 (0) 49 779 064 - +383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aritovic@rks.gov.net
 Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

		<p>pasurisë që është në pronësi dhe kontroll të organizatës, e cila duhet të verifikohet fizikisht dhe të krahasohet me regjistrat e pasurisë jo-financiare.</p> <p>Gjatë auditimit neve na është dhënë vetëm një dokument i nxjerrë nga komisioni i inventarizimit i emëruar nga Kryetari i Komunës, në të cilin thuhet se të gjitha pasuritë janë evidentuar, por mungojnë dëshmitë të cilat vërtetojnë një gjë të tillë. Pra mungojnë të dhënat mbi pasuritë e verifikuara, gjendjen e tyre dhe krahasimet me regjistrat e pasurisë. Për këtë nuk kemi marrë ndonjë sqarim nga zyrtarët përgjegjës.</p>	<p>pasurive të verifikuara dhe të krahasuara me regjistrin e pasurive. Gjithashtu duhet të sigurojë se pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria siç e kërkojnë rregulloret në fuqi si dhe të hartojë procedura të brendshme rreth pasurisë.</p>		<p>on dhe zhvillim ekonomik.</p>		
--	--	--	---	--	----------------------------------	--	--

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel: +383 (0) 280 315 001. Mob: +383 (0) 49 779 064; +383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aritonovici@rks.gov.net
 Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

		<p>Sipas rregullore 02/2013 për menaxhimin e pasurisë neni 6, pika 3 pasuria nën 1,000€, duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.</p> <p>Komuna nuk përdorë programin E-pasuria për evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë nën 1,000€.</p> <p>Sipas zyrtarëve komunal ka pasur probleme teknike në përdorimin e sistemit e-pasuria dhe për atë arsye nuk është përdorur.</p> <p>Sipas nenit 4 të rregullore 02/2013, Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e</p>					
--	--	--	--	--	--	--	--

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel : 383 (0) 280 315 001. Mob : 383 (0) 49 779 064 / 383 (0) 44 824 282 e-mail : vladica.aritonovic@rks.gov.net
 Adresa: Ndërrresa e Komunës së Ramllugut, P.n. 62000, Komuna e Ramllugut, Republika e Kosovës

		pasurisë jo financiare. Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë të komunës.						
8.	2.3 Të arkëtueshmet Çështja B1 – Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme	Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L.005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27. Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, shitja e shërbimeve, nga taksat e biznesit dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Do të mnderrmiren masa ndaj borgjeli-njeve sic jane adresimi i vrejtjeve dhe kontakteve me qellim te inkasimit me te madh te borgj-it.			31-12-2020	
					Xhavit Krasniqi, drejtor i drejtoratit per buxhet, financa, in-spekcion dhe zhvillim ekonomik.			

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel : 383 (0) 280 315 001; Mob : 383 (0) 49 779 064 ; 383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aritonovic@rks-gov.net
Adresa: Ndërtesa e Komunes së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

		<p>përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.</p> <p>Komuna për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë 195,302€ të cilat krahasuar me vitin e kaluar ishin rritur për 27,412€, nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e tyre siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë.</p> <p>Sipas nenit 56 të rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, ndër të tjera si mekanizëm</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel: +383 (0) 280 315 001 Mob - 383 (0) 49 779 064, +383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aritovic@rks.gov.net
 Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ramllugut, P.n. 62000, Komuna e Ramllugut, Republika e Kosovës

		<p>për mbledhje të borxhit parashihen edhe veprimet si: borxhliut i dërgohet urdhër për pagesë të taksës me vërejtjen për përmbarim, kamata do të fillojë të llogaritet nga data e vendosur në vendim për arkëtimin e borxhit; ndërprerja e veprimtarisë afariste (mbyllja për tri ditë); malli do të regjistrohet dhe do të merret (konfiskimi i pasurisë) dhe shitja e pasurisë përmes ankandit.</p> <p>Të arkëtueshmet nga shitja e shërbimeve (mbledhja e mbeturinave) në fundi të vitit 2019 ishin 131,149€, që i bie nga viti i kaluar janë rritur për 20,889€. Të arkëtueshmet nga taksat në biznes kishin arritur vlerën 54,063€, krahasuar</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel +383 (0) 280 315 001, Mob - 383 (0) 49 779 064, +383 (0) 44 824 282 e-mail vladica.aritomovic@rks-gov.net
 Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

		më vitin paraprak ishin rritur për 6,383C. Komuna nuk kishte ndërmarr veprime për mbledhjen e tyre siç parashihet me rregullore.					
9.	2.4 Detyrimet Çështja A7 - Vonesa në pagimin e faturave	Sipas Rregullës Financiare 01/2013 MF, neni 37.1 përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë. Gjatë testimit, shtatë mostra vlerë prej 5,474C janë paguar me vonesë, duke tejkaluar afatin për pagesë prej 30 dite . Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së mjeteve financiare, si dhe me rastin e korrigjimit të faturave të cilat nuk ishin në rregull gjatë pranimit.	Rekomandimi A7 Kryetari duhet të siguroj që faturat e pranuar të paguhen brenda afatit ligjor si dhe të siguroj që kthimi i faturave të parregullta bëhet përmes protokollit.	Te gjitha faturat nese jane ne rregull do te Paguhen ne afat ligjor dmth. Brenda 30 diteve.	Xhavit Krasniqi, Drejtor i drejtoratit per buxhet, Financa, inspektion dhe zhvillim ekonomik.	31-12-2020	

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel + 383 (0) 280 315 001, Mob + 383 (0) 49 779 064, + 383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.aronovic@rks.gov.net
Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

10.	<p>2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm</p> <p>Çështja B2 – Mungesa e komitetit të auditimit</p>	<p>Udhëzimi administrativ MF-nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4.1 themelimi i komitetit të auditimit: Çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.</p> <p>Komuna e Ranillugut ende nuk ka themeluar Komitetin e Auditimit. Sipas auditorit të brendshëm, "Përkundër vullnetit të menaxhmentit për të themeluar Komitetin e Auditimit (KA),</p>	<p>Rekomandimi B2</p> <p>Kryetari duhet ta themeloj Komitetin e Auditimit në mënyrë që puna e NjAB-së të monitorohet dhe të jetë e pavarur dhe efektive përmes zbatimit të rekomandimeve.</p>	<p>Duke iu referuar legjislacionit në fuqi, kam aprovuar kërkesën e Drejtorit të NjAB-ës për shfrytëzimin e të drejtës për pushim pa pagesë. Nga Njësia Qendrore e Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, nëpërmjet një marrëveshjeje do të kërkoj sigurimin e shërbimit të brendshëm për vitin kalendarik 2020/21.</p>	<p>Kryetari i komunës</p>	<p>30 shtator 2020</p>	
-----	---	--	--	--	---------------------------	------------------------	--

Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel + 383 (0) 280 315 001, Mob + 383 (0) 49 779 064; + 383 (0) 44 824 282 e-mail vladica.aritonovic@rks.gov.net
Adresa: Ndertesa e Komunës së Ranillugut, P.n. 62000, Komuna e Ranillugut, Republika e Kosovës

		mungesa e buxhetit për kompensimin e mëditjeve për anëtarët e tij ka ndikuar në mos-themelimin e tij".					
--	--	--	--	--	--	--	--


Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit ne jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të Veprimit.

- Së bashku me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës do të harmonizojmë agjendën e takimit për shqyrtimin e Raportit të Auditimit në mbledhjen e radhës së së Kuvendit (gjatë muajit korrik); dhe
- Deri në fund të muajit janar 2021, do të diskutoj në Asamblenë Komunale për progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2020 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave;
- Po ashtu, në kohë reale do të dorëzojmë Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Ranillug,

Data 07-08-2020

Vladica Artonović, Kryetar i Komunës




Zyra e Kryetarit të Komunës

Tel. + 383 (0) 280 315 001; Mob. + 383 (0) 49 779 064; + 383 (0) 44 824 282 e-mail: vladica.artonovic@rks.gov.net
Adresa: Ndërtesa e Komunës së Ranillgut, P.n. 62000, Komuna e Ranillgut, Republika e Kosovës

